



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:104601

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429900

P.2023:130558

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit N.N, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, Kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, të pandehurit B.L, për shkak të veprës penale Sulmi në tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 592/2023 të datës 09.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 04.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdulla Abedini, të pandehurve dhe mbrojtësit të pandehurit N.N – Avokat Sh. V., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I

N.N, nga fshati ., Komuna e Kaçanikut dhe me vendqëndrim ne Zvicerr Hauental ...qyteti ... , i lindur me datë ..., nga i ati H... e ëma H... e gjinisë Rr..., me numër personal:..., i martuar, prind i 4 femijeve, punon me biznes privat ne Zvicerr , ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTE FAJTOR

Sepse Më datën 07.05 2023, rreth orës 14:00, në fshatin Vatë, Komuna Kaçanik i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi, një armë zjarri të tipit "...", 1 karikator, 12 fishekë të kalibrit 9x19 mm dhe 1 thikë, të cilat janë sekuestruar nga ana e policisë.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par 1 të KPRK-së

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

1. Me dënim me gjobë në shumë 1500€ (Njëmijë e pesëqind euro), të cilin dënim me gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara.

2.1. Konform nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, një armë zjarri të tipit "...", 1 karikator, 12 fishekë të kalibrit 9x19 mm dhe 1 thikë, konfiskohet në mënyrë të përhershme.

2.2. Sendet e konfiskuara pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi lejohet asgjësimi i tyre të cilin do ta bëjë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar.

3. Detyrohet i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 30.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.

Ndaj të pandehurve N.N, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit B.L, për shkak të veprës penale Sulmi në tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 592/2023 të datës 09.06.2023.

- PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimin 11/24 e datës 04.03.2024 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimin e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit – të dëmtuarit N.N dhe të pandehurit - palës së dëmtuar B.L

- HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.592/2023 të datës 09.06.2023, pasi që lënda është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimin.

- Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, ka ngritur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr. 592/2023 të datës 09.06.2023, kundër të pandehurit N.N, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, Kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ndaj të pandehurit B.L, për shkak të veprës penale Sulmi në tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 04.03.2024

Në këtë seancë për të pandehurit N.N, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit B.L, për shkak të veprës penale Sulmi në

tentativë nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, lënda është referuar në ndërmjetësim me pëlqimin e palëve.

Arsyetimi për pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri N.N e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, Kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ka deklaruar se është penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris me këso lloj te veprave penale

Mbrojtësi i të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë sa i përket aktakuzës ne pikën 2, pranimin e fajësisë e beri ne mënyrë vullnetare, duke shprehur keqardhje dhe duke kërkuar falje, andaj ka kërkuar nga gjykata sa i përket llojit te lartësisë se dënimit te mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim me gjobë për shkak se konsideruar se një dënim i tille do ta përmbush qëllimin e larte te dënimit dhe po ashtu do te shërbej si preventiv qe ne te ardhjen mos te ketë ndonjë vepër te njëjtë penale apo ndonjë tjetër.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi qe një pranim te tille e beri vullnetarisht pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe duke pasur parasysh pasojat dhe benifitet e pranimit te fajësisë dhe një pranim i tille mbështetet ne provat qe i mbështetet kjo aktakuzë, i ka propozuar gjykatës qe ketë pranim ta aprovoj dhe te pandehurit ti shqiptoj një dënim me gjobë ne lartësi prej 1500 €. Gjykata ti merr te gjitha këto rrethana renduese te cilat janë te parapara me nenin 69 te KPRK-se, ndërsa si rrethanë lehtësuese ne kuptim te kësaj dispozite ta merr pranimin e fajësisë.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, Kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe

me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit N.N plotësohen ë gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve, nga neni 366 par 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit N.N, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, është penduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen dhe gjendjen e mesme ekonomike të deklaruar nga ana e tij, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi sanksion si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për konfiskimin

Konform nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, një armë zjarri të tipit "...", 1 karikator, 12 fishekë të kalibrit 9x19 mm dhe 1 thikë janë konfiskuar në mënyrë të përhershme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Arsyetimi për pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit

Sa i përket pikës II të këtij Aktgjykimi Gjykata me kërkesën dhe pëlqimin e palëve e ka referuar lenden në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimi 11/24 e datës 04.03.2024

Lidhur me shpenzimet procedurale sa i përket pikës II të këtij Aktgjykimi është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:130558, më datë 08.03.2024

Procesmbajtësja:

Indira Beqa

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.